



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROKURORII PËRGJITHSHËM**

UDHËZIM

Nr. 1 Datë 17. 04. 2003

PËR

**MASAT NDALUESE QË DUHEN MARRË NDAJ NËPUNËSVE CIVIL KUR
PROCEDOHEN PENALISHT**

Me synim,

- për të garantuar një procedim të drejtë, të barabartë dhe të rregulltë ligjor ndaj nëpunësve civil ne luftën kundër fenomeneve korruptive, duke mbrojtur lirit personale dhe të drejtat e interesat e iigjëshme të shtetasve;
- për të mbrojtur interesat dhe imazhin e mirë, që duhet të kenë në publik, nëpunësit civil të Administratës Publikeve, si dhe;
- për të shmangur qëndrimet e gabuara që janë mbajtur në Administratën Publike të nivelit qëndror apo vendor, për rastet kur nëpunësit civil, përfshi dhe punonjësit e Policisë së Shtetit, megjithëse të proceduar penalisht, kanë vazhduar të qëndrojnë në detyrat apo funksionet e mëparshme.

Mbështetur, në nenin 24 pika 4 e vijues të K. Pr. Penale, nenin 8 pika 2 të ligjit Nr. 8737 datë 12. 02. 2001 "Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë " dhe ligjin Nr.8549 datë 11. 11. 1999 "Statusi i nëpunësit civil",

UD H Ë Z O J:

1. Prokurorët, kur procedojnë penalisht nëpunës civil të Administratës Publike në nivelet qëndror apo vendor, përfshi edhe punonjës të Policisë së Shtetit¹, për vepra penale të kryera për shkak të detyrës ose për krime të rënda, t'i kërkojnë, fillimishtë, emërtesave përkatëse pezullimin e tyre nga detyra apo funksioni, deri në marrjen e një vendimi përfundimtar².

¹ Shih Vendimin KM Nr. 117 datë 27. 02. 2003 "Për njësirnin e funksioneve të Policisë së Shtetit me funksionet përkatëse në Administratën Publike.

² Ligjin Nr.8549 datë 11. 11. 1999 "Statusi i nëpunësit civil", neni 22 pika 2, gërmaat" dhe Ligji Nr. 8553 datë 25. 11. 1999 "Për Policinë e Shtetit", neni 29 gërma "dh".

2. Në rastet kur emërtesa përkatëse, nuk vendos pezullimin e nëpunësit civil nga detyra ose funksioni, drejtuesi i prokurorisë dhe/ose prokurori, duhet:
 - 2.1. të njoftojnë menjëherë drejtorinë përkatëse të strukturës së kësaj zyre që mbikqyrë procedimet për veprën penale të kryer nga nëpunësi civil, si dhe;
 - 2.2. të kërkojnë në gjykate, krahas një nga masat shtërnguese, të parashikuar në nenet 232 pika 1 gërmat "a-ç" dhe 233-236 të K. Pr. Penale, marrjen edhe të masës ndahiese "pezullim i ushtrimit të një detyre a shërbimi publik", duke respektuar kërkesat ligjore, nenet 241-242 tëK. Pr. Penale.
3. Në rastet kur ndaj nëpunësit civil, prokurori kërkon dhe gjykata vendos caktimin e masës shtrënguese "arrest në burg" ose "arrest në shtëpi", nenet 232 pika 1 gërmat "d-dh" dhe 237-238 të K. Pr. Penale, është e panevojshme marrja e masës ndaluese "pezullim i ushtrimit të një detyre a shërbimi publik".
4. Për të ndjekur dhe kontrolluar zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen prokurorët dhe drejtuesit e Prokurorisë të të gjitha niveleve dhe strukturat e kësaj zyre.
5. Mospërmbushja e detyrave të përcaktuara në këtë udhëzim, përbën shkelje të disiplinës në punë, neni 32 gërma "b" e ligjit Nr.8737 datë 12. 02. 2001 "Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë".
6. Me këtë udhëzim të njihen prokurorët dhe drejtuesit e Prokurorisë të të gjithë niveleve.
7. Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

PROKURORI I PËRGJITHSHËM

THEODHORI SOLLAKU
